

URAN BUTKA: “LUFTA CIVILE NË SHQIPËRI (1943-1945)”

**Një botim që i shërben të vërtetës historike
Shtypshkronja “Drier”, Tiranë, 2006, 626 f.**

Gjatë Luftës II Botërore Shqipëria përjetoj pushtimin e saj nga fuqitë fashiste-naziste të kohës, Italia e Gjermania, me pasojat që rrodhën si dhe qëndresën ndaj tij. Gjithashtu është fakt historik se, në këtë periudhë Shqipëria përjetoj dhe realitetin e luftës civile, i cili u shpalos midis forcave politike të qëndresës shqiptare, thelbi i së cilës ishte lufta për pushtet.

Pranimi ose mospranimi i ekzistencës së fenomenit të luftës civile ka përbërë një nga temat më të nxehta të debatit në historiografinë shqiptare të këtyre 15 vjetëve të fundit. Në themel të këtij debati, lidhur me çështjen e pranimi ose mospranimi të luftës civile, qëndrojnë interesat politike të atyre grupimeve sociale e politike shqiptare, të cilat janë lidhur akoma me nostalgjinë për të kaluarën. Në këto grupime sociale, për fat të keq bëjnë pjesë dhe historianë, të cilët duke e mbivlerësuar rezistencën antifashiste të shqiptarëve, përpiqen ta monopolizojnë duke ia atribuar vetëm një forcë politike shqiptare të drejtuar nga PKSh. Qëllimi është i qartë: duke e konsideruar si të vetmin aset dhe trashëgimi të këtyre grupimeve sociale e politike, historianët kërkojnë t’i japin legjitimitet pushtetit të tyre politik në të shkuarën, në të sotmen dhe në të ardhmen.

Me fjalë të tjera, historiografia komuniste u përpoq të legjitimojë pushtetin e saj për më shumë se 50 vjet. Njëherazi, ajo mohoi faktin historik se pushteti i tyre u vendos me dhunë e me gjak, nëpërmjet zhvillimit të luftës civile, kundër të gjithë forcave politike, të cilave jo vetëm u mohuan qëndresën në luftën çlirimtare, por u atribuan vetëm tradhtinë dhe bashkëpunimin me okupatorin. Ky është një shtrembërim i historisë.

Ndaj edhe libri “Lufta civile në Shqipëri 1943-1945” përbën një kontribut të rëndësishëm në shërbim të shpalosjes së vërtetës historike, për një dukuri të errët të historisë së shqiptarëve në vitet e Luftës II Botërore.

Libri i Uran Butkës radhitet ndër ato botime serioze të historiografisë sonë më të re, të cilat hedhin dritë për realitetin historik të luftës civile të shqiptarëve në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Shtysa e patundur e autorit në ndërmarrjen e këtij studimi ka qenë shpalosja e së vërtetës, sepse “E vërteta, - thotë ai, duke iu referuar Umberto Ekos, - do të na bëjë njerëz plotësisht të lirë”. Ai merr përsipër të thotë të vërtetën historike, në mënyrë që shqiptarët ta perceptojnë saktë historinë e tyre dhe ajo t’iu shërbejë si mësuese e jetës. Njëherazi, ai kërkon dhe synon të përgënjeshtrojë shtrembërimet dhe deformimet që i janë bërë historisë shqiptare. “Ai që nuk e di të vërtetën, - thotë B. Brehti, duke iu referuar historianëve, - është një budalla. Ai që e di dhe thotë një gënjeshtër është një kriminel”.

Botimi “Lufta civile në Shqipëri” i bën anamnezën, pothuajse të plotë këtij fenomeni mjaft të rrezikshëm për shoqërinë shqiptare, në kohën kur ai u shfaq dhe për pasojat që do të kishte më vonë.

Duke ecur në gjurmët e shkrimeve dhe të studiuesve të tjerë, Butka i gjen rrënjët e fenomenit të luftës civile tek fakti i prishjes së njëanshme të Marrëveshjes së Mukjes (1-2 gusht 1943) nga PKSh. Deri në këtë datë, në historinë e qëndresës antifashiste të shqiptarëve ka dominuar përpjekja për bashkëpunim e forcave të ndryshme politike shqiptare në luftën kundër pushtuesit të huaj italian. Përpjekjet për bashkëpunim kanë gjetur shprehjen më të qartë edhe në veprimet e aksionet e përbashkëta të këtyre forcave në krahina të ndryshme. Madje, ky bashkëpunim është konkretizuar edhe në arritjen e marrëveshjeve lokale midis forcave nacionaliste dhe të atyre nacionalçlirimtare, nën drejtimin e PKSh.

Uran Butka sjell fakte e dokumente të shumta që flasin për këtë bashkëpunim të forcave të rezistencës shqiptare, që nga fillimi i vitit 1943 deri në gusht-shtator të këtij viti. Hulumtimi dhe trajtimi i këtyre ngjarjeve të rezistencës antifashiste nga të gjitha forcat politike në Shqipëri, përbën një ndihmesë shkencore të autorit për të ndriçuar strategjinë politike-ushtarake të forcave të rezistencës në Shqipëri. Pikërisht, ky realitet historik është mohuar nga historiografia e mëparshme, duke e deformuar në mënyrë tendencioze historinë shqiptare të kësaj periudhe. Qëllimi ishte i qartë: për të treguar papajtueshmërinë e thellë të programeve të forcave politike shqiptare, që në fillimet e rezistencës dhe për t’i vënë një bazë “objektive” luftës civile për pushtet.

Në këtë botim, si dhe në shkrime të tjera, U. Butka ka trajtuar e analizuar Mbledhjen e Mukjes, si ngjarja më kulmore politike në

procesin e afrimit e të bashkëpunimit të organizuar të forcave politike shqiptare. Në trajtimin e kësaj ngjarjeje, ai ka argumentuar se në vendimet e kësaj Mbledhjeje nuk kishte asnjë vendim që përmbante premisën e ndarjes e të veçimit të forcave politike që arritën marrëveshjen. Përkundrazi, në Marrëveshje kishte vendime që bënin të mundur plotësisht bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e forcave politike shqiptare në shërbim të çështjes së çlirimit kombëtar.

Autori, duke analizuar Marrëveshjen e Mukjes dhe ngjarjet fill pas saj, ka sjellë fakte dhe argumente për qëndrimin refraktar dhe të ashpër të krahut më sektar të udhëheqjes së PKSh me Enver Hoxhën në krye. Nga kjo analizë del në mënyrë të qartë edhe ndikimi i emisarëve jugosllavë pranë udhëheqjes së PKSh, duke i imponuar këtij të fundit vendimin për të mos e pranuar Marrëveshjen e Mukjes dhe për ta hedhur poshtë atë. Zbulohet qartë dhe në mënyrë të dokumentuar pozita nënshtruese dhe servile e kësaj pjese të udhëheqjes së PKSh ndaj emisarëve jugosllavë.

Autori ka evidentuar me dokumente e fakte të bollshme momentin e shpërthimit të luftës civile, përgatitjen e terrenit nga PKSh, që çonte drejt armiqësisimit dhe të konfrontimit të forcave nacionaliste me ato nacionalçlirimtare.

Muaji shtator 1943, sipas autorit, ishte përgjithësisht muaji i terrorit, i asgjësimit të figurave të njohura nacionaliste jo vetëm në forumet qendrore, por dhe në ato lokale. E gjitha kjo bëhej për të përcjellë panik, frikë, diferencim në radhët e Ballit Kombëtar. Viktima të këtij terrori pati në Berat, Mallakastër, Vlorë, Devoll, Tepelenë, Leskovik etj.

Mbështetur në dokumentet e kohës, autori vëren se, në muajt shtator-tetor 1943, goditja dhe asgjësimi ushtarak i Ballit Kombëtar u bë në ato zona e krahina ku Lëvizja Nacionalçlirimtare kishte epërsi politike dhe ushtarake, siç ishte zona e Korçës.

Në libër del qartë dukuria se, në dy muajt e parë pas Marrëveshjes së Mukjes u ndie edhe ndikimi pozitiv i kësaj marrëveshjeje. Disa aksione ushtarake të përbashkëta të Ballit dhe të partizanëve, gjatë muajve gusht-shtator 1943, dëshmonin më së miri për vlerën reale të Marrëveshjes së Mukjes. Ndonëse e hodhi poshtë menjëherë Marrëveshjen e Mukjes, udhëheqja ekstremiste komuniste nuk arriti të frenojë e pengojë frymën entuziaste e mobilizuese që ngjalli Marrëveshja e Mukjes, në çastet e para.

Konferenca II Nacionalçlirimtare e Labinotit (4-9 shtator 1943) është bërë objekt trajtimi i veçantë. Ajo vendosi dhe shpalli si detyrë themelore të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të drejtuar nga komunistët, marrjen e pushtetit nga ana e tyre me dhunë dhe vetëm për vete, pa e ndarë atë me asnjë forcë tjetër politike. Marrja e një vendimi të tillë, ku pushteti dilte në plan të parë, ishte dëshmi e qartë se Lëvizja Nacionalçlirimtare me në krye PKSh, ishte shmangur nga lufta kundër pushtuesit për çlirimin e vendit. Me këtë qëndrim dëshmoi se i ishte larguar përfundimisht vijës politike të shpallur prej saj, për bashkimin e të gjithë shqiptarëve në luftë kundër pushtuesit pa dallim krahine, feje e bindjeje politike.

Propaganda komuniste u intensifikua pas kësaj Konference për të bërë, siç thotë autori, bolshevizmin e luftës, duke i dhënë luftës së tyre më shumë karakter politik për marrjen e pushtetit dhe duke iu shmangur luftës çlirimtare. Autori e ka cilësuar Konferencën e Labinotit si themel të totalitarizmit komunist në Shqipëri.

Direktivat dhe vendimet për kalimin në luftë civile nuk ndodhën në mënyrë spontane, të kushtëzuara nga rrethana historike imponuese. Përkundrazi, vendimi i PKSh për shpalljen e luftës civile ishte llogaritur mirë dhe bënte pjesë në programin e saj. Ajo i shfrytëzoi rrethanat historike për të maskuar qëllimin e saj të luftës për pushtet. Nga një anë ajo shpallte në propagandën e saj, vijën e bashkëpunimit kundër pushtuesit të ri gjerman, nga ana tjetër jepte direktiva për luftë kundër bashkëpunëtorëve ballistë. Kjo propagandë e dyfishtë ishte mjaft e djallëzuar, çoroditëse, ishte shfrytëzim i situatës kundër bashkëpunimit real midis forcave politike.

Në librin e U. Butkës është provuar qartë se, komunistëve ekstremistë nuk e mjaftonte vetëm propaganda kundër nacionalistëve, për t'i ndërsyer shqiptarët në luftën vëllavrasëse, por iu duhej dhe nxitja e urrejtjes për kundërshtarin e tyre, për veprime terroriste kundër disa krerëve nacionalistë, të cilët, me fjalën e qëndrimin e tyre frymëzonin besim për arritjen e bashkëpunimit midis forcave politike.

Gjithashtu veprimet terroriste brenda radhëve të organizatës nacionalçlirimtare dhe partisë komuniste synonin të kallnin tmerr e frikë, për të shtypur, kështu, çdo përpjekje apo tendencë për t'iu kundërvënë strategjisë së zhvillimit të luftës civile.

Në librin “Lufta civile në Shqipëri 1943-1945” u jepen përgjigje pikëpyetjeve, dilemave e qëndrimit të Ballit Kombëtar pas shpalljes së

luftës civile, rreth të cilave ka pasur mjaft spekulime. Kështu është shpjeguar drejt direktiva e Mithat Frashërit, e 7 tetorit 1943, për pezullimin e veprimeve kundër gjermanëve. Autori e konsideron këtë direktivë si një qëndrim taktik dhe jo si dokument komprometues të Ballit Kombëtar për bashkim me gjermanët. Sillen fakte për dilemën e nacionalistëve pas imponimit të luftës civile. Për ta mbeti si e vetmja strategji, mbrojtja nga goditja e forcave nacionalçlirimtare dhe jo sulmi kundër tyre. Duke iu referuar veprimeve të luftës civile në krahinën e Kolonjës, konstatohet se në 95% të ndeshjeve midis forcave kundërshtarë, iniciativën e sulmit e kishin pasur forcat nacionalçlirimtare, nën drejtimin e komunistëve. Në faqet e librit shpalosen faktet dhe ndodhitë e luftës civile me gjithë egërsinë e saj. Madje, edhe më të ashpra se sa luftimet kundër pushtuesit, siç ndodhi në luftimet e forcave partizane kundër Dukatit (Vlorë), në fund të nëntorit 1943 etj.

Herë pas here sillen në vëmendjen e lexuesit fakti se, në ndodhitë e luftës civile nuk kishte as gjermanë, as rusë ose të huaj të tjerë, për të vënë në dukje se konfrontimi ishte vetëm midis shqiptarëve me bindje të ndryshme politike për pushtet dhe jo kundër pushtuesve. Ai vë në dukje se “populli ishte indoktrinuar nga forcat politike”. Ndërsa PKSh përçonte një ideologji e politikë të huaj për shqiptarët, nacionalistët mbështeteshin tek atdhetarizmi shqiptar, i cili kishte gjetur mishërim tek shqiptarët, sa herë që vatani i tyre ishte sulmuar për t’u pushtuar.

Autori i jep përmasat e zhvillimit të luftës civile me të dhëna nga burime të ndryshme informacioni, duke lënë të kuptojë që vetë lexuesi të perceptojë përmasat e ballafaqimeve midis forcave dhe rezultatet e tyre. Burimet e ndryshme të informacionit i kanë dhënë mundësi autorit të tregojë lavdërimet që u bënte propaganda komuniste vetëm disa ngjarjeve, që ishin në interes të saj.

Nuk kanë dalë jashtë vëmendjes së autorit dhe rrjedhojat sociale të kësaj lufte. Me propagandën çoroditëse në çdo familje shqiptare, për të luftuar kundër njëri-tjetrit, konstatohet se u tronditën vlerat e shëndosha morale të familjes dhe të shoqërisë shqiptare. Sipas konceptit komunist, për zhvillimin e luftës civile “shkakun do ta krijonin edhe atje ku ai nuk ishte i pranishëm”. Kundërshtarët politikë duheshin quajtur “armiq e kriminelë” që të përlligjej lufta kundër tyre si luftë çlirimtare dhe të justifikoheshin veprimtaria kriminale e komunistëve.

Në libër argumentohet përçapja e misionëve britanike për të frenuar e penguar zhvillimin e luftës civile, të shpallur nga komunistët.

Njëherazi, del qartë dhe vendosmëria e Enver Hoxhës për ta çuar deri në fund strategjinë e tij për vendosjen e pushtetit komunist, pa përfunduar lufta botërore. Sipas autorit, mos hapja e frontit të dytë të luftës nga anglo-amerikanët në Ballkan, ndikoi në vendosmërinë e komunistëve për të qenë konsekuent në luftën e tyre për pushtet. Ndërkohë, duke iu referuar raporteve britanike, vihet në dukje se “forca e partizanëve duket se qëndron në disiplinën e tyre, në energjinë e tyre dhe në qartësinë e qëllimit të tyre, cilësi që për çudi, u mungojnë kundërshtarëve të tyre nacionalistë”.

Pohime të tilla të raporteve britanike mendohet se bëheshin për t’iu shmangur përgjegjësisë së politikës së tyre për mbështetjen që iu dhanë komunistëve shqiptarë për vendosjen e pushtetit politik. Përpjekjet e britanikëve për të realizuar bashkëpunimin e forcave të rezistencës shqiptare kundër gjermanëve, duke shfrytëzuar edhe emrin e Ahmet Zogut, dolën pa sukses. Qëndrimi i diplomacisë britanike ndaj mbretit Ahmet Zogu, duke e konsideruar si “kartë e djegur”, të cilit “i ka kaluar koha”, për të mos e njohur si mbret, e zhvlerësuan rolin e tij për të ndikuar në ngjarjet politike dhe ushtarake në Shqipëri. Mosnjohja e A. Zogut si përfaqësues legjitim i sovranitetit të shtetit shqiptar të paraluftës nga ana e Britanisë së Madhe, vinte për shkak të ndjeshmërisë britanike ndaj pretendimeve greke në çështjen e kufijve të Shqipërisë, të cilët ishin vënë në dyshim edhe në deklaratën britanike të dhjetorit 1942.

Mund të duket e pabesueshme që qeveria britanike mbështeste vendimin e Kongresit të Përmetit për mosnjohje të ndonjë qeverie shqiptare të formuar jashtë saj, se sa të njëjta A. Zogun, si përfaqësues legjitim i shtetit shqiptar të paraluftës, me të cilin të ndikonte në zhvillimin e ngjarjeve politike-ushtarake në Shqipëri.

Libri zbulon me fakte të shumta se në procesin e luftës civile promotorë ishin komisarët, që ishin anëtarë të PKSh, të cilët merrnin e zbatonin në mënyrë të verbër urdhrat e udhëheqjes së saj.

Uran Butka sjell risi në botimin e tij duke evidentuar bashkëpunimin konkret të komunistëve me forca të huaja në luftën kundër nacionalistëve, siç ishte bashkëpunimi me mbeturinat e ushtrisë italiane (që u futën në radhët e ushtrisë partizane), si dhe me forcat partizane jugosllave e greke. Bashkëpunimi i komunistëve me këto forca të huaja, për të mposhtur nacionalistët, ishte shpesh herë vendimtar në këtë luftë civile. “Pa ndihmën e ushtarakëve italianë, do të deklaronte Hulusi Spahiu, - ne kurrë nuk do t’i mundnim forcat nacionaliste dhe të

bajraktarëve të Veriut. Në çdo brigadë partizane që kaloi Shkumbinin kishte nga një kompani italianësh, mortajash dhe artilerie. Ata ishin shumë të përgatitur dhe me një përvojë disavjeçare”.

Në libër dokumentohet dukshëm dhe dukuria e mobilizimit të minoritetit grekofon të Shqipërisë, në luftë kundër forcave nacionaliste në jug të Shqipërisë.

Lufta civile në Shqipëri kulmon në verën dhe vjeshtën e vitit 1944 kur njësitë e UNÇ kalojnë në Shqipërinë e Veriut, për të goditur Abaz Kupin, Parinë e Matit, të Dibrës, Muharrem Bajraktarin e Lëvizjen Kryeziu. Këtu spikatën veprimet e terrorit të kuq komunist, në bashkëpunim edhe me forcat partizane jugosllave ndaj gjithë kundërshtarëve të tyre, duke i identifikuar me emrin “reaksonarë”. Likuidimi i tyre u udhëhoq nga parulla “o me ne, o kundër nesh”. Në këtë fazë të luftës civile, terrori e masakrat e forcave partizane kundër nacionalistëve dhe përkrahësve të tyre u bënë masive.

Është rasti të vëmë në dukje se autori Butka për rrjedhojat fatale të kësaj lufte përdor emërtimin “viktima të luftës civile”, pa treguar ndonjë preferencë tendencioze, në krah të njëres apo tjetres palë ndërluftuese. Për të është e qartë se, pavarësisht nga shkaktarët e kësaj lufte, ata që e paguanin ishin viktimat që binin në fushën e saj dhe si të tillë ata duhen përkujtuar, për të mos u përsëritur tragjedia. Duke qenë se viktimat nga radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare janë vlerësuar e glorifikuar nga “fitimtarët”, për mbi 50 vjet, madje, janë shpallur dhe heronj të popullit apo dëshmorë, autori e ndien si obligim moral të studiuesit, të evidentojë me emra, kur është e mundur, të gjithë viktimat e kësaj lufte civile nga radhët e forcave nacionaliste, duke u bërë homazh si studiues.

Më tej ai bën sqarimin se “Statusi i dëshmorit duhet t’u jepet vetëm luftëtarëve që bien në luftë drejtpërdrejt kundër pushtuesve të huaj”. Diferencimi që u është bërë dhe iu bëhet viktimave të luftës civile sipas përkatësisë politike provokon shqetësime të mëdha në shoqërinë tonë, e cila vuan, veç të tjerash, edhe nga plagët e historisë. Ndaj, autori bën thirrje që “historia duhet të korrigjojë vetveten”.

Me trajtimin e gjerë të problemit të luftës civile në Shqipëri, Uran Butka jo vetëm sjell fakte të bollshme në argumentimet e tij, por bën dhe përgjithësime me interes. Një ndër ta është përfundimi se “Lufta civile i shkaktoi vendit më shumë viktima se sa lufta kundër pushtuesve” (f. 322). Përfundime të tilla, të mbështetura në fakte të shumta, të

dokumentuara bindshëm, me siguri do ta shtyjnë më tej mendimin historiografik nëpërmjet debateve shkencore.

Pasqyrimi i fakteve historike me dokumente në një libër të tillë, për Luftën civile në Shqipëri (1943-1944), të interpretuara me maturi dhe objektivitet, me siguri do të lëkundë mendimin edhe të atyre historianëve skeptikë që akoma nuk e pranojnë këtë realitet historik të shqiptarëve në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Libri i Uran Butkës, nëpërmjet shpalosjes të së vërtetës historike që i është fshehur lexuesit me mënyra të ndryshme, përcjell mesazhe paqeje shpirtërore për shoqërinë shqiptare. Në fund të fundit, ai i bën një shërbim të çmuar historisë sonë të vërtetë, me mësimet që rrjedhin prej saj.

Muharrem DEZHGIU